



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 11.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 10.10.2024, të parashtruar nga OE "TONI INGJINJERING SH.P.K Llapushnik, Magjistranja, M9, Gllogoc" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët.", me Nr. të Prok: 613-24-10149-5-2-1 nxjerr:

## V E N D I M

**I Refuzohet**, kërkesa për ri-shqyrtim e OE "TONI INGJINJERING SH.P.K Llapushnik, Magjistranja, M9, Gllogoc" të dt. 10.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët.", me nr. të Prok: 613-24-10149-5-2-1

**Vërtetohet** Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit të publikuara në platformen elektronike e-prokurimi të datës 27.09.2024.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, ka pranuar kërkesë për Ri-Shqyrtim nga OE "TONI INGJINJERING SH.P.K Llapushnik, Magjistranja, M9, Gllogoc" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Llot 1 Ndërtimi i urës metalike në fshatin Hallaq i Vogël, Llot 2 Rregullimi i kanalizimit në rrugën Aleksandër Stipcevic, Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët.", me Nr. të Prok: 613-24-10149-5-2-1.

Me pretendimet sic vijon:

Ne bazë të kërkesave të kërkuara nga Zyra e Prokurimit në piken 9.1 dhe 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, të LOT3 në piken b) Minimumi një inxhinjer i diplomuar master ose beqellor minimumi 5 vite përvojë pune të jetë i qertifikuar për

mbikqyrje te projekteve ne infrastrukture dhe siguri shendet ne punë. c)Minimumi një gjeodet bachelor apo master i diplomuar dhe i licencuar se paku 3 vite pervojë. e)Minimumi një salldues te qertifikuar Kerkosat e jueja si AK nuk jan lelevante per ket aktivitet te prokurimit te Lot3 te pika b),kjo kerkese është se pari e pa kuptueshme sepse nuk ceket drejtimi i inxhinjerit dhe pjesa e fjalis: te jet i qertifikuar per mbikqyrje te projekteve ne infrastrukture dhe siguri shendet ne punë. Është e tepert per arsye se aktivitet te prokurimit te Lot3 nuk ka te bajë me mbikqyrje te projektev tjera apo projekteve qe ka kontraktu komuna e Lipjanit por ka me kry apo impleментu një rrjet ajror te ndriqimit publik.Sipas ksaj ky ingjinjer qe nuk ka drejtim te cekur (inxh. t elek, ndertimit, bujqsis,astronomis apo diqka tjeter) por cili do qoftë është i pa nevojshem. - Kerkoi nga AK qe pika b) te llot3 te largohet si kerkese apo si kriter ne dosjen e tenderit sepse është kerkese diskriminuese dhe e pa nevojshme. c)Minimumi një gjeodet bachelor apo master i diplomuar dhe i licencuar se paku 3 vite pervojë. Ne paramasen e dhenë ne ket aktivitet te prokurimit nuk kemi has as një pozicion qe ceket te behet ndoni inqizim te gjeodetit apo diqka tjeter lidhur me gjeodezi.Prandaj kjo kerkese është e pa nevojshme si kriter i pergjedhjes. -Kerkoi nga AK qe pika c) te llot3 te largohet si kerkese apo si kriter ne dosjen e tenderit sepse është kerkese diskriminuese dhe e pa nevojshme. e)Minimumi një salldues te qertifikuar Ne paramasen e dhenë ne ket aktivitet te prokurimit nuk kemi has as një pozicion qe ceket te behet ndoni salldim, rregullim te shtyllav metalik apo diqka tjeter lidhur me perpunim te metaleve salldime etj.Prandaj kjo kerkese është e pa nevojshme si kriter i pergjedhjes.

#### **Pretendimi 1**

**Minimumi një inxhinier i diplomuar master ose beachelor minimumi 5 vite përvoj pune të jetë i Certefikuar për mbikqyrje të projekteve në infrastrukture dhe siguri shendet ne punë.**

#### **Pergjigjeja.**

**Kjo kërkesë e AK është vendosur për tu dhën mundesi OE që inxhiniri i paraqitur ne FTD të jetë i fushës së Inxhinierisë, pa dashur ta kufizoj një drejtim të caktuar.**


Per pretendimin e pare dhe te tjera - Autoritet kontraktues duke u bazuar dhe duke i'u referuar përshkrimit të çmimeve për të 3 llotet i ka vendosur edhe kushtet minimale për pjesëmarrje, përkatësishte kërkesat dhe dëshmitë për këtë aktivitet të prokurimit që janë të nevojshme per realizimin e projektit në fjalë, që duhet të plotesohen nga OE ofertues, përveq kushteve minimale të vendosura në FTD gjithashtu si rikujtim OE kanë mundesi që të kenë marrveshje me OE për Pajisje dhe Staf,.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit